



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0924**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Isa Hasani-Referues dhe Vedat Poterqoi-anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-3949-1-1-1, me 01/02/2024, mori:

## **Vendim**

**I.** Hedhet e palejuar ankesa e OE Ndërmarrja Tregtare Grafike “Blendi” O.P e parashtruar me datë 20/11/2023 [Protokolli: 2023/0924] kurse vendimi i Komunës së Prishtinës nga cilësia e autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore në Komunë të Prishtinës” me numër të prokurimit 616-23-3949-1-1-1, mbetet në fuqi.

**II.** Në afat prej 10 ditësh, autoriteti kontraktues duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrja lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

**III.** Kthehen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.

Me 25.04.2023, Komunës e Prishtinës duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me tabela të mençura (smart) për institucionet arsimore të Komunës së Prishtinës” numër 616-23-3949-1-1-1, për të cilin është zhvilluar procedurë e hapur, lloji i kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 400.000.00 €.

Me 31.10.2023, Autoriteti Kontraktues me të dhëna si më sipër, ka publikuar njoftimin lidhur me vendimin e tij/saj, sipas të cilit e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik SolVIT ShPK.

Me 06.11.2023, anëtarë ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e autoritetit kontraktues të datës 10.11.2023

Me 20.11.2023, kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, Ndërmarrja Tregtare Grafike “Blendi” O.P ka parashtruar ankesë në OSHP, e regjistruar me numër 2023/0924.

*Në fazën e shqyrtimit paraprak, OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është parashtruar brenda afatit ligjor sikurse parashihet me nenin 109 paragrafi 1 dhe është ushtruar pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse kërkohet edhe kjo në kuptim të nenit 108/A të LPP, megjithatë ankesa nuk i përmban të gjitha elementet qenësore të parapara me dispozitën e nenit 111 të LPP. Në të vërtetë sipas paragrafit 1.5 të nenit 111, kërkohet që ankuesi ta vërtetojë faktin, cituar: “se kualifikohet si “palë e interesuar” siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji”. Kurse sipas nenit 4, paragrafi 1.26. parashihet shprehimisht se palë e interesuar, konsiderohet personi [nënkupto: fizik dhe/ose juridik] i cili siç thuhet, cituar “mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose...”.*

Në këtë rast, shikuar në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, rrjedhës së aktivitetit të prokurimit akteve dhe veprimeve të palëve të përfshira, është jo kontestues fakti se ankuesi është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit me vendimin tani të atakuar të autoritetit kontraktues. Mirëpo ankuesi nuk e ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të autoritetit kontraktues mbi bazën e shkaqeve dhe arsyeve të cilat kërkohet shprehimisht me paragrafin 1.8. të nenit 111, të LPP, sipas të cilit kërkohet nga ankuesi, cituar: “të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës...” Kështu, në kontekstin e shpjegimeve si më sipër, OSHP vëren se:

- se ankuesi nuk e ka ushtruar ankesë për të dëshmuar interesin material, të tij/saj, sikurse kërkohet kjo me paragrafin 1.26. të nenit 4;
- nuk e ka ushtruar ankesën në harmoni me paragrafin 1.8 të nenit 11, sipas të cilit kërkohet që të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose mund t’i shkaktojë dëme

materiale;

Duke i analizuar të gjitha këto, OSHP në këtë rast konsideron se duhet i referohet dispozitës së nenit 31, paragrafi 2, të Rregullores për punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, sipas të cilit, cituar: "...Paneli duhet ta konsideroj ankesën si të pa bazuar edhe nëse po të mos kishte asnjë shkelje të ligjit, ankuesi nuk do të kishte gjasa për fitimin e tenderit". Prandaj në rastin konkret, konstatohet se ankuesi nuk e ka statusin e palës së interesuar, i cili konsiderohet kusht i domosdoshëm për shqyrtimin dhe vendosjen meritorë në kuptim të nenit 105 të LPP, sipas të cilit OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara në këtë Pjesë IX që ti shqyrtojnë ankesat nga, cituar "palët e interesuara".

*- Përfundim -*

Bazuar shkurtimisht në shpjegimet si më sipër OSHP konsideron se ankuesi nuk e ka statusin e palës në këtë çështje, në mënyrën se si është rregulluar kjo shprehimisht me dispozitat e cituara si më sipër të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, prandaj OSHP nuk është lëshuar në shqyrtimin e përmbajtjes dhe pretendimeve, ngase ato në këtë rast konsiderohen me karakter jo relevant. OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore i cili me 18.12.2023, ka dorëzuar Raportin me rekomandimin që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, duke e lenë në diskrecion të këtij Organi nëse ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet apo të kthehet në rivlerësim me arsyet se, ankuesi është shpallur i papërgjegjshëm më parë edhe me vendimin e OSHP PSH. Nr.0433/2023 kurse, OE i propozuar për kontratë është i papërgjegjshëm në bazë të gjetjeve të ekspertit. Një formulim i tillë se OE i propozuar për kontratë "është i papërgjegjshëm në bazë të gjetjeve të ekspertit" nuk gjen vend në këtë rast përderisa instituti juridik "palë e interesuar" nuk është konstatuar fare sipas këtij raporti. Në të vërtetë, raporti i një eksperti shqyrtues, roli dhe hulumtimet e tij/saj, i takojnë fazë përgatitore, respektivisht shqyrtimit paraprak dhe si i tillë ka karakter deklarativ dhe nuk krijon efekte detyruese as për palët (operatorin ekonomik dhe autoritetin kontraktues) dhe as për Organin e sidomos kur një raport i tillë nuk është mbështetur në prova dhe argumente konkrete. Asnjë Raporti i ndonjë eksperti shqyrtues nuk mbisundon mbi dispozitat e karakterit kogent, të precizuara me nenet 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP. Andaj rekomandimet e ekspertit shqyrtues nuk kanë gjetur zbatim sipas gjykimit të pavarur dhe/ose diskrecionit të këtij Organi. Nga ana tjetër, OSHP tani më është në dijeni lidhur me të gjitha faktet dhe rrethanat përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit dhe natyrisht është në dijeni për të gjitha faktet dhe rrethanat të cilat kanë pasur ndikim relevant në procesin e vendosjes nga ana e autoritetit kontraktues nga ky Organ.

Sidoqoftë i mbetet Autoritetit Kontraktues që nga kuadri i kompetencave të tij në vështrim të nenit 24 të LPP-së të kujdeset për ligjshmërinë e veprimeve nga kuadri i këtij aktiviteti të prokurimit në harmoni me dispozitën e cituar sipas së cilës: "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" e duke vazhduar me kujdesin e tij/saj në implementimin e drejtë të dosjes së tenderit dhe siç kërkohet me dispozitën e nenit 59 të LPP "të

konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”

Meqë në kontekstin e pohimeve ankimore vërehet se ankuesi e ka atakuar vendimin e autoriteti kontraktues vetëm në raport me operatorin ekonomik të rekomanduar nuk përbën bazë të mjaftueshme për ta hapur procesin e administrimit të provave dhe/ose për ta anuluar eventualisht një vendim të tillë për faktin se ankuesi nuk është fitues i këtij tenderi . Në këtë rast duhet kujtuar se autoriteti kontraktues nga cilësia e tij si institucion i administratës publike ka kapacitetet organizative dhe profesionale dhe te drejtë që ta themeloj komisionin vlerësues i cili udhëhiqet nga përgjegjësia gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, sikurse kërkohet kjo shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 59 të LPP-së.

Prandaj nisur nga të lartcekurat, Paneli Shqyrtues, duke vepruar në bazë të nenit 102, lidhur me nenin 98, 99, 105 dhe 111 të LPP është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vjosa Gradinaj**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P.**
- Arkivës së OSHP-së: